



V E N D I M  
Nr. 72, datë 30.11.2017

PËR  
MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME  
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS  
FINANCIARE PËR FAMILJET E Z.LULASH PRENDI DHE Z.SHKELZEN  
HASANI, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI

Mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, neni 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 8, datë 30.01.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2017”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 30.11.2017, pas diskutimeve,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Lulash Prendi** në vlerën prej **40,000 lekë (dyzet mijë)**, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Shkelzen Hasani** në vlerën prej **100,000 lekë (njëqind mijë)**, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
3. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017 të miratuar me VKB nr.8, datë 30 01 2017, në programin P13, F1 O2 A1.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër.

5. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 948,857 lekë dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 194,400 lekë sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z.Lulash Prendi, në total **1,143,257 lekë (një milion e njëqind e dyzet e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë lekë)**.
6. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 1,257,549 lekë dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 202,560 lekë, sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z.Shkelzen Hasani në total **1,460,109 lekë (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e nëntë lekë)**.
7. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Punëve të Brendshme për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjet e z. Lulash Prendi dhe z. Shkelzen Hasani, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
8. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 140,000 lekë.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.11.2017

Shpallur në datën 1.12.2017

**Sekretar i këshillit**

**Suel Hadri**

**KRYETAR**

**Xhemal BUSHATI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Pr. 18837 18.12.17 Sektori Juridik & Sektori i Perballimit te Emergjencave & Krizave

Nr1234/1 Prot

Shkoder me 15.12.2017

**Lënda:** Mbi vendimin nr.72 datë 30.11.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale te ligjit Nr.107/2016 dt 27.10.2016 “Për Prefektin”, në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, neni 29, neni 64 germa c, ligjit Nr.8756,dt. 26.03.2001 “Per emergjencat civile”, i ndryshuar, VKM NR.329 dt.16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhezimit të Ministrave të Financave dhe të Ministrise se Brendshem Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore”, VKM Nr.629 dt 15.07.2015 “Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre”, VKB Nr.8 dt 30.01.2017 “Mbi miratimin e buxhetit te bashkise Shkoder 2017”, shqyrtoi vendimin Nr.72 datë 30.11.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër:“Mbi miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare të menjehershme **Z. Lulash Prendi** fshati Hoti i Ri NJA Rrethina ne shumën 40.000 leke marrë nga fondi i emergjencave civile 2017 dhe vlere totale dokumentacioni tekniko-ligjor në shumën 1.143.257 leke si dhe dhenien e ndihmes se menjehershme **Z. Shkelzen Hasani** fshati Shtoj i Vjeter NJA Rrethina ne shumen 100.000 leke marre nga fondi emergjencave civile 2017 dhe vlere totali dokumentacionit tekniko-ligjor ne shumen 1.460.109 leke, banesat e te cileve jane demtuar nga zjarri”.

Pas shqyrtimit konstatohet:

- A. Te preventivi ndertimor te **z.Shkelzen Hasani** te zeri (kepje suvatim i brendshem) eshte percaktuar çmimi 169 leke, ndersa te **Lulash Prendi** për të njëjtin ze punimi eshte vendosur çmimi 146 leke, - vlere e sakte per te cilen ju duhet te procedoni është 146 lekë.
- Te Shkelzen Hasani Zeri i punimeve me nr.Analize 516 Tuba Plasmasi 0100 mm është vendosur 313 lekë dhe jo 263 lekë. (të saktësohet)
  - Konstatohet mospërputhje mes aktit te PMNZSH-se në të cilin është cituar se është djegur nje dhome qe perdorej si magazinë, ndersa sipas procesverbalit te konstatimit dt.13.10.2017 eshte trajtuar si dhome banese, të saktësohet gjatë procedimit për dërgim dokumentacioni në MB, DPEC,
- B. Ne te dy rastet e preventivave ndertimore te familjeve eshte perfshire TVSH-ja 20%, në kundërshtim me Udhezimet e Ministrise se Puneve te Brendshme Nr.806 prot dt 8.02.2017 (derguar juve me tonën Nr.221/1 prot dt.17.03.2017)- të saktësohet vlere totale gjatë procedimit duke bërë diferencën.
- C. Sipas Sektorit te perballimit te krizave dhe emergjencave civile eshte konstatuar se te preventivat perkatese te te demtuarve nuk jane vendosur datat e perpilimit te akteve per efekt te verifikimit te praktikave lidhur me afatet perkatese, referuar VKM Nr.329 dt. 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të

shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore". pasaktësi,

D. Lidhur me vlerësimin e orendive dhe paisjeve elektro-shtëpiake çdo artikull duhet të jetë i specifikuar sipas listës të çmimeve.

Përsa më sipër, Prefekti ju autorizon të procedoni për dhënien e ndihmës financiare familjeve të dëmtuara nga situata të tilla, duke konsideruar prioritet familjet e dëmtuara të cilat nuk mund të penalizohen nga pasaktësitë e stafit administrativ, me kusht që të bëhen të gjitha saktësimet sipas akteve ligjore në fuqi.

Me respekt,

PREFEKTI

Cesk MILLIJA

